



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV-të
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 81/12
Prishtinë, më 22.10.2012, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Duda Balje, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj dhe Muhamet Mustafa.

Mungoi: Albana Fetoshi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, dhe Kushtrim Aliu (praktikant).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Basri Musmurati Zv. Ministër i Administrimit të Pushtetit të Lokal dhe Agron Maxhuni Drejtor i Departamentit Ligjor në MAPL, Rrahman Paçarizi Kryetar i Bordit të RTK-së, Sylejman Shaqiri Drejtor Gjeneral në RTK dhe Bujar Spahiu Drejtor Financiar në RTK, Alexander Beetz, Lukas Fischer, Juergen Schatz, Rejhane Zylfijaj, Ramadan Islami dhe Njomza Ilazi (GIZ), monitorues nga KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
3. **Shqyrtimi i Projeksioneve të buxhetit të RTK-së për periudhën Tetor – Dhjetor 2012;**
4. **Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit të Pavarur për Media lidhur me kompenzimin e anëtarëve të KPM-së;**
5. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja bëri vërejtje për mospërgatitjen e procesverbalit të mbledhjes së fundit dhe radhitjes së tij për miratim në këtë mbledhje. Edhe më herët është nga anëtarët e komisionit është ngritur dhe është kërkuar që procesverbali i mbledhjes së fundit të përgatitet dhe të radhitet për miratim në mbledhjen e radhës. Kërkoj

nga stafi që mbështet punën e komisionit, të jetë më i kujdesshëm dhe të përgatit procesverbalin me kohë. Më pas rendi i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Kryetarja theksoi se nga deklarata financiare vërehet se projektligji përmban implikime buxhetore shtesë. Për të marr informata më të detalizuara lidhur me këtë çështje, kemi ftuar përfaqësuesit nga ministria e pushtetit lokal të cilëve iu kaloi çështjen.

Agron Magjuni ndryshim plotësimi i këtij PL ka si qëllim tërheqjen e investimeve dhe krijimin e lehtësirave për investitorët me potencialet e brendshme por edhe të jashtme. Dhënia e pronës komunale për investim ka si qëllim zgjerimin e transaksioneve dhe se një gjë e tillë vlerësohet si pozitive nga ana e Ministrisë së Financave. Deklarata e Ministrisë së Pushtetit Lokal, nuk parasheh kosto shtesë dhe vlerëson se ky PL do të ketë ndikim pozitivë në rritjen e të hyrave vetanake të komunave pasi që parasheh kriteret për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Të hyrat e parapara për komunat arrijnë vlerën prej 3 milion euro të cilat parashihen të vjelën nga interesat që do të paguheshin për shfrytëzimin e pronës komunale. Zgjatja e afati për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale prej 40 viteve, ndikon në zhvillimin ndërkombëtar pasi që ofron mundësi për ofrimin e investitorëve të jashtëm. Ky proces është një praktikë e vendeve të rajonit dhe ka qenë një kërkesë e kamotshme e komisionit evropian dhe USAID-it programe të cilat mbështesin qeverisjen lokale.

Naser Osmani a ka një ligj më të hershëm që e rregullon çështjen dhe a ka të bëjë vetëm me pjesën e investitorëve apo konsiderohet si prioritet i komunës që është në dobinë e përgjithshme të qytetarëve. Sepse një gjë e tillë rregullohet edhe me ligjin e AKP-së për tokën e ndërrmarjeve shoqërore që është më interes për komuna, që mund të bëhet ky këmbim. Përse po përmendet 40 vjet kur kjo çështje është e rregulluar me ligjin për PPP-të. Sipas interesit të komunës a është më mirë të jetë e kufizuar apo e pa kufizuar dhënia në shfrytëzim e pronës komunale?

Agron Magjuni ky ligj plotëson dhe ndryshon ligjin e mëhershëm që ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, ligj i cili ka dy kapituj dhënien e pronës në shfrytëzim dhe PPP-të. Ky ligj e zëvendëson ligjin e AKP-së, ndërsa kufizimi prej 40 vite ka ndikuar negativisht në tërheqjen e investitorëve pasi që nuk kanë pasur interes të investojnë në komuna. Prioriteti i këtij ligji mbetet zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik si dhe lehtësimi i procedurave të dhënies së pronës komunale në bazë të ankandit publik. Pronat komunale mund tu ipen edhe institucioneve nga të cilat kemi shumë kërkesa mirëpo deri tani nuk ka pasur procedurë të dhënies në shfrytëzim. Afati maksimal është 99 vjet sepse komuna nuk ka të drejtë të shes tokë andaj është bërë një kufizim i tillë, pas të cilave bëhet një transferim i butë dhe e gjithë pasuria mbetet e komunës.

Kryetarja theksoi se nga sqarimet e ofruara, shifet se projektligji është i përballueshëm për buxhetin dhe gjithashtu është në favor të komunave pasi që i rrisin të hyrat vetanake.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, komisioni njëzëri nxori:

REKOMANDIM

Projektligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës është i përballueshëm për buxhetin e Kosovës dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë

3. Shqyrtimi i Projektioneve të buxhetit të RTK-së për periudhën Tetor –Dhjetor 2012;

Kryetarja në takimin e kaluar ku kemi kërkuar disa sqarime mbi kërkesën buxhetore të RTK-së. Këto arsyetime kanë ardhur nga RTK-ja, dhe të gjithë i kemi marrë materialet në kohë. Këtu janë përfaqësuesit e RTK-së të cilët mund të shpjegojnë arsyen e lëvizjes nga disa vija buxhetore.

Latif Gashi menaxhmenti i RTK-së ka sjellur sqarimet shtesë. Edhe pse ka mundur të menaxhohet më mirë, duhet marrë parasysh se RTK-ja i ka pasur disa obligime të cilat i ka trashëguar dhe të cilat po i'a sjellin këto probleme. Unë jam dakord që komisioni të rekomandojë aprovimin e këtyre projeksioneve.

Kryetarja tash pasi që është proceduar ligji i ri, nuk do të jetë procedura e njëjtë e raportimit siq ka qenë çdo tre muaj. Por edhe kësaj radhe ne do të japim një rekomandim lidhur me projeksionet buxhetore për 3 mujorin e fundit të këtij viti.

Naser Osmani mendoj që është e nevojshme të diskutohet çështja e tejkalimeve buxhetore pasi që kjo është një problematikë, ndërsa tjerat janë brenda kornizave të parapara. Duhet treguar se përse po ndodhin këto tejkalime, a është si rezultat i mos mbikëqyrjes së duhur apo ka arsye të tjera për të cilat do të duhej të na informonit.

Sylejman Shaqiri të gjitha këto tejkalime janë si rezultat i mungesës së mjeteve dhe obligimeve nga vitet e mëparshme. Edhe tejkalimet të pagat janë si rezultat i shndërrimit të kontratave të përkohshme me kontrata të rregullta. Në vitin 2007 për arsye që nuk jam kompetent të flas janë shndërruar në kontrata jo të rregullta me qëllim të zvogëlimit të numrit të punëtorëve të rregullt dhe ajo ka qenë joligjore. Prandaj na është dashur që ato kontrata të shndërrohen në kontrata të rregullta pasi që janë detyrime që na ka sjell ligji i punës. Tejkalimet tek programet janë çështjet sportive për të cilat ligji na ngarkon të sigurojmë transmetimin e ngjarjeve të mëdha sportive.

Naser Osmani tejkalimet mund të ndodhin tek investimet kapitale, mallra dhe shërbime por nuk guxon të ndodhë në paga sepse ato janë mirë të planifikuara. Por edhe nëse nuk janë mirë të planifikuara ju duhet të respektoni buxhetin e aprovuar. Këtu shihet se kemi tejkalime dhe ky tejkalim i paraqitur këtu a do të mbetet tejkalim edhe në fund të vitit. Nëse po, atëherë ne do të hyjmë me obligime në vitin 2013. Përse janë shndërruar kontratë e përkohshme në të rregullta, pa u informuar apo pa kërkuar lejin e mjeteve shtesë nga Kuvendi?

Sylejman Shaqiri ne jemi duke i bërë të gjitha përpjekjet e mundshme që vitin 2012 të mos e përfundojmë me humbje ose të jenë minimale.

Latif Gashi në takimin e kaluar kam kërkuar të bini arsyetime shtesë, dhe këtu i kemi arsyetimet ku shihet se disa faktorë të cilat kanë ndikuar në tejkalimet buxhetore kanë qenë rritja e pagesës së sigurimit shëndetësor të punëtorëve të RTK-së si rezultat i nënshkrimit të kontratës kolektive.

Muhamet Mustafa kam kërkuar sqarime jo për tre muaj apo për çdo muaj, mirëpo kam dashur të shoh sitatën deri në fund të vitit në mënyrë që të gjejmë një zgjidhje. Këtu po shihet që deficitin nuk është duke u zvogëluar por përkundrazi po rritet. Ne nuk dimë se sa janë të ardhurat për Janar-Shtator 2012 dhe as për tre mujorin e fundit të këtij viti. A mundeni ti mbulonit shpenzimet e parapara me buxhetin e mbetur?

Bujar Spahiu sqaroi se material shtesë që i është dërguar Komisionit për buxhet dhe financa, janë të paraqitura të hyrat e detajuara për periudhën Tetor-Dhjetor 2012.

Kryetarja ndryshimet e bëra për periudhën e fundit nuk e ndryshojnë pozicionin në total të buxhetit, por kemi ndryshime në shumat e buxhetit për disa kategori, si ato të pagave dhe mëditjeve dhe kjo ka ndodhur si rezultat i lëvizjeve të brendshme prej një kategorie në tjetrën.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, komisioni njëzëri nxori:

REKOMANDIM

1. I rekomandohet Administratës së Kuvendit, të transferojë mjetet buxhetore nga buxheti i Kuvendit – kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në xhirollogarinë e RTK-së nr.1110101219060187, për periudhën 1 tetor – 31 dhjetor 2012, në shumën prej 2,165,000 Euro.

4. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit të Pavarur për Media për kompensimin e anëtarëve të KPM-së.

Kryetarja njoftoi për përmbajtjen e kërkesës së KPM-së që i është drejtuar Kuvendit që shprehin pakënaqësi me pagat e tyre aktuale. Përmes kësaj kërkesë shprehin pakënaqësinë për pagat aktuale, konkretisht kryetari 200 euro kurse anëtarët 150 euro, të cilat janë përcaktuar më herët në bazë të një vendimi të Qeverisë. Ligji për Komisionin e Pavarur për Media, ka përcaktuar se niveli i kompensimit të kryetarit edhe anëtarëve të KPM-së caktohet me ligjin mbi pagat e zyrtarëve të lart publik, i cili nuk ekziston. Anëtarët e këtij Komisioni nuk janë bord ekzekutiv dhe marrin kompensim për pjesëmarrje në mbledhje. Kryesia e Kuvendit ka kërkuar që komisioni të shqyrtojë këtë çështje dhe të dal me rekomandime.

Sali Asllani u befasova kur mësova nivelin e pagave të këtij komisioni. Kompensimi që marrin është shumë i ulët për një institucion kaq të rëndësishëm që merret me rregullimin e fushës së mediave. Do të ishte mirë të bëhej një analogji me agjencionet tjera të pavarura në çështjen e përcaktimit të pagave të tyre dhe të kenë një prag më të dinjitetshëm.

Latif Gashi theksoi se ka pasur rastin të merr pjesë në takimet kur është shqyrtuar ligji i komisionit të pavarur për media dhe ka pasur zëra që kanë propozuar që anëtarët e këtij komisioni të jenë ekzekutiv dhe në marrëdhënie të rregullt pune dhe menaxhmenti ka qenë kundër këtij propozimi dhe të paguhen në formë të honorarit. Ky dallon prej bordeve tjera dhe mendoj që në mungesë të ligjit për pagat e zyrtarëve të lartë publik, duhet të rekomandoj që paga aktual që kanë të aplikohet, pasi që nuk kemi bazë ligjore për të rekomanduar për pagë të re. Nëse vendosim ndryshe do të mund të krijohet një praktikë e rrezikshme dhe do të na vërshojnë kërkesa nga më të ndryshme nga agjencionet e pavarura për rregullimin e pagave.

Muhamet Mustafa vlerësoi se ajo qfarë thotë zoti Latifi e ka logjikën, mirëpo duke ditur rëndësinë e këtij komisioni si ndër më të rëndësishmit do të duhej të bëhej diçka për pagat e tyre brenda buxhetit të tyre, pasi kanë përgjegjësi të madhe.

Kryetarja duke iu referuar zotit Mustafa, sqaroi se për të ekzekutuar pagat kërkohet vendim që përcakton saktësisht pagat e tyre dhe kjo nuk është e lehtë të ekzekutohet.

Naser Osmani theksoi se Komisioni për Buxhet dhe Financa në të kaluarën ka rekomanduar për caktimin e pagave të të gjitha bordeve dhe funksionarëve të lartë, madje edhe të Presidentit, Kryeministrit dhe Kryeparlamentarin. Kemi një problem pasi që kemi një buxhet të miratuar për këtë vit për KPM-në dhe po ta ngrisim nivelin e pagës nuk kemi mjete për me pague. Andaj kam një propozim që këtë kërkesë të kemi parasysh kur të shqyrtohet projektbuxheti 2013. Të bëhet nivelizimi me bordet tjera të ngjashme. Është e

domosdoshme të ngritet pragu i nivelit të kompenzimit se anëtarët e këtij komisioni janë të përkushtuar në punë dhe nuk kanë dy vende të punën.

Latif Gashi theksoi nuk dëshiron të keqkuptohet se është kundër kërkesës, por se nuk kemi bazë ligjore për përcaktimin e nivelit të pagave të tyre. Unë jam për me gjetur një formë për rritjen e pagave të tyre, por të kemi kujdes se mos po biem në kundërshtim me me Ligjin e KPM-së që vet e kemi miratuar.

Naser Osmani nëse bazohem në bazën ligjore, edhe pagat aktuale janë joligjore pasi që mungon ligji që do të duhej të përcaktonte këtë. Unë mendoj që duhet të bëjmë një zgjidhje të përkohshme, gjatë shqyrtimit të buxhetit të vitit të ardhshëm të rekomandohet për nxjerrjen e një vendimi i vlefshëm deri në miratimin e ligjit i cili e rregullon këtë çështje.

Muhamet Mustafa propozoj që t'iu themi se nuk mundet me u rrit buxheti i përgjithshëm këtë vit, dhe nëse kanë mundësi me ndryshue kategoritë, atëherë të na informojnë për ato ndryshime, e ne t'iu japim një pëlqim për caktimin e atij pragu të ndershmë.

Kryetarja nga diskutimi u kuptua se gjatë këtyre tre muajve është e pamundur të gjejmë një zgjidhje, pasi që nuk mund të bëjmë ndryshimin e buxhetit të këtij komisioni. Me qenë se ligji për pagat e funksionarëve të lartë publik është kthyer në qeveri, ne gjatë fazës së shqyrtimit të projektbuxhetit të analizojmë dhe të rekomandojmë për nivelin e pagave në formë të mëditjeve për anëtarët e KPM-së dhe ti drejtohem Kryesisë së Kuvendit. Po ashtu ne do të duhej të shqyrtonim e çështjen e nivelit të pagave të avokatit të popullit dhe zëvendësve të tij, anëtarëve të këshillit të pavarur për shërbimin civil për të cilit ligjet përkatëse thonë se pagat e tyre përcaktohen me ligjin për pagat e funksionarëve të lartë publik.

Naser Osmani Kuvendi duhet të nxjerr vendimin në bazë të rekomandimeve të komisionit.

Sali Asllanaj pikërisht këtë desha ta themë se brenda këtyre tre muajve është e pamundur të bëhet një zgjidhje. Megjithatë, mendoj që duhet të bëhet një zgjidhje për përcaktimin e nivelit të pagave më të ndershme për anëtarët e këtij komisioni.

Hasimja Krasniqi nga diskutimet u thanë ato që unë i kisha në plan dhe mendojë që duhet ti analizojmë të gjitha bordet dhe të përpiqemi të bëjmë harmonizimin në mes tyre në bazë të rëndësisë dhe funksionit që kanë.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

1. Bazuar në Ligjin nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media, niveli i kompenzimit të pagave për kryetarin dhe anëtarët e Komisionit të Pavarur për Media, është paraparë të caktohet me Ligjin për pagat e zyrtarëve të lartë, i cili ligj nuk ekziston.
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa, me rastin e shqyrtimit të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, do të shqyrtojë kërkesën e Komisionit të Pavarur për Media për përcaktimin e nivelit të pagave për anëtarët e KPM-së, dhe do të dal me rekomandime për Kuvendin.

Mbledhja përfundoi: 12:45

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona

